



PËRGJITHSHME

I. SYNIMET E

Udhëzimi i njerëzve në rrugë të drejtë, në fenë e vërtetë, në dritë, në monoteizëm, në drejtësi, në mëshirë dhe humanizëm. Argumente që vërtetojnë këtë ka shumë. Allahu në Kur'an thotë:

“????? ???? ??? ?????? ??? ??????

Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme...” Ali Imran, 104.

“????? ????????? ???? ????? ???????

Ç'është e vërteta, ti i fton ata në rrugë të drejtë.” El-Mu'minune, 73.

“????? ?????? ??? ?????? ???????* ????? ????????? ?? ?? ?? ????????? ??? ?? ?????????? ??? ?????????

... Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë. 53. Në rrugën e All-llahut, të cilit i takon çka ka në qiej dhe çka ka në tokë, e ta dini se të gjitha çështjet janë me vullnetin e All-llahut.” Shura, 52-53.

“??? ??? ???

...e ti thirri te Zoti yt...” el-Haxh, 67.

“?? ????? ????? ?? ????? ????????????? ?? ????? ?????

...Thuaj: "Unë jam urdhëruar që ta adhuroj vetëm All-llahun, e mos t'i bëj shok Atij..." Rra'd, 36.

**"????* ???? ?????? ???? ?????? ?????? ?? ?????? ??? ?????? ???? ???? ????
???? ?????? ??????"**

Elif, Lam, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; (t'i nxjerrësh prej errësirës) në rrugë të Fuqplotit, të Falënderuarit." Ibrahim, 1.

Ummeti islam është ummeti më i mirë i ardhur për këtë qëllim, pikërisht siç thotë Allahu:

"???? ??? ???? ?????? ?????? ?????? ?????????? ?????? ?? ?????? ?????????? ?????"

Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndalonin nga veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun..." Ali Imran, 110.

Ndërsa xihadi me fjalë, pasuri dhe shpatë nuk është ligjësuar për tjetër vetëm se për realizimin e këtij qëllimi. Rebi' Ibni Amiri e përmbloodhi çështjen e xihadit si barrë e ngarkuar ummetit islam, në bashkëbisedimin që zhvilloi me Rustemin, komandantin persian. Kur Rustemi e pyeti: Përse erdhët? (Çfarë dëshironi?) Rebiu ia ktheu:

**?? ?????????? ?????? ?? ??? ?? ?????? ?????? ??? ?????? ?? ?????????? ??? ???
????????? ??? ?????? ??? ??? ?????????????? ??? ?????????"**

Vërtetë, Allahu na dërgoi që ta nxjerrim kë të dojë Ai nga adhurimi i njerëzve në adhurimin e Zotit të njerëzve, nga ngushtësia e kësaj dynjaje në gjerësinë e saj dhe nga padrejtësia e feve në drejtësinë islame."[\[1\]](#)

Ndërsa qëllimi dhe synimi kryesor dhe më i rëndësishëm i Thirrjes (Daves) tonë është nxjerrja e njerëzve nga errësira në dritë dhe udhëzimi i tyre në rrugën e cila i shpëton nga zjarri i Xhehennemit. Synojmë që të largojmë njerëzit nga ferri i jobesimit në parajsën e besimit, nga errësira e kufrit në nurin e udhëzimit, nga errësira e injorancës në dritën e dijes, nga bota e mëkateve në botën e respektimit. Këto janë qëllimet e Thirrjes tonë, siç thotë Allahu:

"??????? ?????? ?????? ?????? ?? ?????????? ??? ?????"

All-llahu është mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë..." El-Bekare, 257.

Profetët, alejhimu's selam, u dërguan që t'i nxjerrin njerëzit nga errësira në dritë, punë të cilën pas tyre e kryejnë thirrësit në të vërtetën.

II. SYNIMET NË DETAJE

1. Krijimi i një ummeti që thërret në rrugën e Zotit dhe lufton në të

Qëllim parësor i Thirrjes Islame është që të nxjerr një ummet të singertë, që do ta adhuronin Allahun po kështu singërisht. Allahu thotë:

“?? ????? ?? ? ? ?????????????????? ????? ?????? ?????? ????????? ???????
???????? ?????????? ?? ? ?????? ?? ??? ??? ??????????”

Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme.” El- Xhumuah, 2.

“??? ? ? ?????? ?????????? ? ? ? ? ? ? ? ? ?????????? ?????? ? ? ? ? ? ? ? ?
????????? ?????????? ?????????? ?????????? ?

Është e vërtetë se All-llahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi të dërguar që atyre t'u lexojë shpalljen e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Kur'anin dhe sheriatin, edhe pse, më parë ata ishin krejtësisht të humbur.” Ali Imran, 164.

“?? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ?????? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ?

Ai është që e dërgoi të dërguarin e Vet me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fé, e mjafton All-llahu dëshmitar.” El-Fet'h, 28.

Ndërsa ummet i singertë nuk nënkupton patjetër që të jenë bashkësi popujsh të singerta por njerëz të singerte nga bashkësi popujsh.

2. Formimi i një besimtari te devotshëm

Pejgamberi, alejhi's selam ka thënë:

“???????? ???? ? ?????????????? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ? ?

Që Allahu ta udhëzojë nëpërmjet teje një njeri të vetëm eshte më mirë për ty se të kesh pasuri të shumtë.” Transmetim unanim.

“???? ?????? ?

(Në Ditën e Kiametit) Vjen profeti ndërsa me vete ka dy burra (që e kanë pasuar), vjen profeti ndërsa me të janë tre burra, vjen edhe me më shumë...”[\[2\]](#)

Kështu, udhëzimi qoftë edhe vetëm i një besimtari në rrugën e drejtë është realizim i një qëllimi të madh të Thirrjes Islame.

3. Argumentimi kundër ateistëve dhe mohuesve (jobesimtarëve)

Argument për këtë kemi ajetin kur'anor:

” ??? ?????? ????? ? ? ? ?????? ?

Allahut sikur që ua tërhoqi vërejtjen që të mos favorizojnë dynjanë ndaj Ahiretit (Kur'ani, el-A'rafë, 74; Kur'ani, esh-Shuara, 146-152.); Shuajbi, alejhi's selam e ndaloi popullin e vet po kështu nga çrregullimet dhe trazirat në tokë (Kur'ani, el-Arafë, 85-86.)

Kështu, shkak i tërë asaj të keqeje që iu ndodhe njerëzve padyshim janë mëkatet, andaj mbetet prioritet i Thirrjes Islame që këtë shkak (mëkatet) ta eliminojë.

Shpallja dhe revelata e të Dërguarit të fundit, Muhammedit, alejhi's selam ka ardhur me urdhër për çdo të mirë, ndalim nga çdo e keqe, largim nga çdo çrregullim në tokë, qoftë kjo edhe në raportet me ambientin (tokën dhe bimët). Allahu ka thënë:

“**??? ????? ?? ????? ???? ?? ?????? ?????? ????? ?????? ?? ?? ????? ??? ??? ??????? ????? ???? ??? ?? ????? ????? ????? ????? ?????**

Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (meqë në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet All-llahun dëshmuës, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë. 205. E posa të kthehet ai në tokë, vepron të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) dhe gjallesat. E All-llahu nuk e do çrregullimin (fesadin).” el-Bekare, 204-205.

5. Krijimi i një klime humaniteti dhe bamirësie në botë

Prej qëllimeve të Thirrjes Islame është që në rendin shoqëror të mbizotërojë e mira dhe veprat e mira. Allahu thotë:

“**?? ????? ?????? ?????? ??????? ??????? ?????? ?????? ?????? ?????? ??????**

O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhurojeni. Bëni punë të mira (të dobishme), se do të gjeni shpëtim.” el-Haxh, 77.

“**????? ???? ?? ???? ???? ???? ???? ?**

Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme...” Ali Imran, 104.

‘E mirë’ është çdo gjë e dobishme; morali i mirë është e mirë, mbajtja e lidhjeve familjare është e mirë, mbjellja e bimëve të dobishme është e mirë, siç thotë Pejgamberi, alejhi's selam:

“**?? ????? ?????? ?? ?? ?????? ?????? ?? ?????? ?? ?????? ?? ?????? ????????**

Nëse ndodhë kataklizmi ndërsa ndonjëri prej jush ka një fidan në dorë, atëherë nëse ka mundësi ta mbjellë atë para se të ndodhë kataklizmi, la ta bëjë!”[\[3\]](#)

Padyshim se nga thirrja e Muhamedit, alejhi's selam përfituan të gjithë, madje edhe ata që e mohuan, siç thotë Allahu:

“**??? ??????? ??????? ????????**

E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” El-Enbija, 107.

Prej parimeve islame që ndalojnë dhunën dhe padrejtësinë dhe aprovojnë drejtësinë, vlerat dhe mirësinë, përfituan popuj e njerëz, edhe nëse nuk kanë hyrë në Islam, siç është rasti me sistemet islame shoqërore, ekonomike, civile, etj. Islami hoqi dhunën dhe padrejtësinë ndaj grave, robërve, të dobëtëve, kështu që njerëzit përfituan nga këto ligje ndërsa nga legjislatura për robërit dhe luftërat përfituan edhe jobesimtarët.

Islami erdhi në kohën kur mbizotëronin injoranca dhe padrejtësia, kështu që ndryshoi rrjedhën historike të njerëzimit; flaku dallimet që ishin si shkaqet të luftërave, si: ngjyrën, gjuhën, vatanin, prejardhjen, dhe aprovoi të vërtetën se të gjithë njerëzit janë nga Ademit dhe se më i miri është më i devotshmi. Allahu ka thënë:

“?? ????? ????? ?? ? ?????? ?? ??? ?????? ?????????? ?????? ??????
????????? ?? ?????? ?? ? ?????????? ?? ????????? ?????

O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” El-Huxhurat, 13.

Burimi: <http://www.dawalh.com/vb/showthread.php?t=4681&page=1>

Përshtati në shqip: Sedat ISLAMI, 2011

[1] El-Bidaje ve-n-Nihaje, 7/39.

[2] Transmetojnë Ahmedi dhe Ibni Maxheh ndërsa Albani në Sahihu-I-Xhamii, 8033, e ka cilësuar autentik

[3] Transmetojnë Ahmedi ne Musned, Buhariu në Edebu-I-Mufred ndërsa Albani në Sahihu-I-Xhamii, 1424, e ka cilësuar autentik.

